

Mësimdhënie e mirë, Edukim i mirë!

Mundësi aftësimi në profesion!

Të dashur studentë të drejtimit parashkollorë!

Fakulteti i Edukimit-Universiteti i Prishtinës, në bashkëpunim me Organizatën Gjermane Internationaler Bund IB, është duke implementuar projektin "Mësimdhënie e mirë, Edukim i mirë"! Me qëllimin që të kontribuojmë në ngritjen e cilësisë së aftësive tuaja në profesion, projekti "Mësimdhënie e mirë, Edukim i mirë!" ofron një seri trajnimesh profesionale në fushën e edukimit të hershëm.

Për të qenë pjesë e këtij programi, ju duhet të plotësoni këto kritere;

- Dëshirën për të zgjëruar njohuritë tuaja në fushën e edukimit të hershëm;
- Te jeni **absolventë** (në vitin e fundit të studimeve) në departamentin e edukimit të hershëm, Fakulteti i Edukimit apo të jeni **të diplomuar** në këtë fushë;
- Të jeni të gatshëm të përfshiheni në një trajnim intenziv një vjeçar, krahas studimeve tuaja;
- Preferohet të keni njohuri bazike të gjuhës Gjermane, por nuk është e domosdoshme.

Trajnimet që do t'i ofrojmë në kuadër të programit janë;

- Aftësi dhe trajnime ndërkulturore;
- Kurse të gjuhës gjermane nga niveli A1 deri në nivelin B2;
- Një punë praktike 4 javore në Gjermani;
- Këshillim profesional në profesion;
- Mbështetje rreth përgatitjes së temës së diplomës suaj (me tematikë edukimin e hershëm).

Për të aplikuar në këtë program, ju duhet të na dërgoni një **e-mail me numrin kontaktues të telefonit**, si dhe nëse posedoni, certifikata që dëshmojnë **njohuri bazike të gjuhës gjermane**. Aplikimi është i hapur deri me datën **31 Tetor 2022**. Intervistat me kandidatët që plotësojnë kriteret parashikohen të mbahen nga data 1 Nëntor deri me datën 4 Nëntor 2022.

Për më shumë informacione rreth programit dhe procedurave të aplikimit, na kontaktoni përmes adresës elektronike kosovo@ib.international apo edhe në konsultime direkt përmes telefonit në këtë numër të telefonit, **+38345706465**, prej orës 09:00 deri në ora 17:00 nga e hëna deri të enjtën.

